VENDIM
Nr. 296, datë 2.5.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 313, DATË 1.7.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 5 të kreut XXX, të lidhjes bashkëlidhur vendimit nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë së komunës, për komunën Ksamil, të bëhet 3 (tre) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 099 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë) veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha